



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 29.06.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 23.06.2021, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “Joos & Krasniqi-Bazë” sh.p.k. dhe kërkesës për ri-shqyrtim të datës 28.06.2021, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “Arfa” SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës pjesa –I-rë, , me Nr. të Prok: 632-21-574-5-1-1, nxjerr:

### V E N D I M

- I. **Aprovohen** si pjesërisht të bazuara kërkesat për ri-shqyrtim të Operatorve Ekonomik: 1. Joos & Krasniqi-Bazë” sh.p.k e dt.23.06.2021 2. “Arfa” SH.P.K, të dt.29.06.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës pjesa –I-rë, me Nr. të Prok: 632-21-574-5-1-1, dhe Nr. Brendshëm 632-21-003-511, kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK –së, të datës 22.06.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
2. Anullohet **NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** e publikuar me datë: 22.06.2021;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që aktivitetin e prokurimit të ktheje ne Ri-vlersim .
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

### A r s y e t i m

Lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës pjesa –I-rë, me Nr. të Prok: 632-21-574-5-1-1, dhe Nr. Brendshëm 632-21-003-511,

Operatori Ekonomik "Joos & Krasniqi-Bazë" sh.p.k, me dt.23.06.2021, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim për lotin c II-të dhe III-të, kurse Operatori Ekonomik "Arfa" SH.P.K, me dt.29.06.2021, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim për lotin I-rë, II-të dhe III-të.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 29.06.2021, ka shqyrtuar kërkesat në fjalë si më poshtë:

Pas rishikimit të dokumenteve, Autoriteti kontraktues, konstaton se disa nga pretendimet e Operatorve Ekonomik "Joos & Krasniqi-Bazë" sh.p.k, dhe "Arfa" SH.P.K, janë pjesërisht të bazuara, prandaj vendos që lëndën të ktheje ne Ri-vlersim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur që lëndën ta kthej në rivlerësim.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;

Arkiviti të Komunës

  
z. Faton Gutaj  
Menaxher i Zyrës së Prokurimit